

PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ZHVILLIMI I VEPRIMTARISE MINERARE TE KERKIM ZBULIMIT DHE
SHFRYTEZIMIT TE MINERALIT TE BAKRIT

ZONA MINERARE NR.177/1, OBJEKTI "VERIU I SPACIT"

(Veprimtaria Kerkim-Zbulim - Shfrytezim)

Me vendndodhje: Njesia Administrative Orosh, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë.

Subjekti: "Tete Albania Tunnel & Mining" sh.a

Hartoi Raportin duke u bazuar ne te dhenat e Projektit dhene nga subjekti;

"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k

Ing. Elidiana Shehu



Mars, 2023

Tabla Permbledhese

1. Qellimin e projektit te propozuar	3
2. Planimetria e vendndodhjes se projektit.....	3
3. Informacion per qendrat e banuara	10
3.1 Skicat dhe Planimetrite objekti “Veriu i Spacit”	12
4. Pershkrimin e proceseve ndertimore dhe teknologjike	23
5. Informacionin per infrastrukturen e nevojshme	26
6. Programin per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatjen e planifikuar per funksionimin e projektit	27
7. Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji);.....	27
8. Informacioni per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/prane zones se projektit;.....	27
9. Informacion per alternativat e marra ne konsiderate, per sa i takon perzgjedhjes se vendndodhjes se projektit dhe teknologjise qe do te perdoret;	28
10. Perdorimi i lendeve te para gjate funksionimit te aktivitetit (uji, energjia, lenda djegese) dhe menyra e sigurimit te tyre	28
11. Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit, si ndertimi i kampeve apo rezidencave.....	29
12. Informacion per lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme per projektin,	29
13. Kopje te lejeve, autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar	29

1. Qellimin e projektit te propozuar

Propozuesi i projektit, shoqëria "TETE Albania Tunnel & Mining" sh.a. është një kompani me eksperiencë shumëvjeçare në fushën e shfrytëzimit dhe pasurimit të bakrit ne vendin tone specifikisht ne Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë. Në kuader te plotesimit te nevojave te fabrikes egzistuese te pasurimit te bakrit shoqëria nepermjet ketij projekti synon kerkim-zbulimin per nxjerrjen e koncentratit shtese të bakrit nga minerali i vendburimit Veriu i Spacit.

Zona minerare nr. 177/1 për të cilën kërkohet leja minerare e kërkim-zbulimit, përfshin periferinë e vendburimit dhe të minierës Spaç Mirditë e clia synon zgjerimin e kufijëve industrialë të vendburimit të Spaçit drejt veriut dhe jugut duke kryer një program punimesh kërkim-zbulimi me punime shpimi.

Minerali për të cilin kërkohet leja e kërkim-zbulimit në rajonin Veriu i Spacit, është minerali i bakrit. Të dhënat e studimeve dhe të punimeve të shumta historike të kërkim- zbulimit, kanë konfirmuar se në këtë rajon kan rezultuar rezultate interesante për shtimin e rezervave të reja të bakrit në kufijtë veriorë dhe jugorë të këtij vendburimi.

Në këtë rajon janë kryer punime të shumta kërkim zbulimi të tilla si; Kanale, puse, pastrime të ndryshme, galeri dhe shpime. Kryesisht në fazën e zbulimit është përdorur metoda e kombinuar me shpime dhe galeri nëntokësore. Janë kryer me qindra shpime dhe qindra ml galeri kërkim-zbulimi.

Por ne vendburimin Veriu i Spacit në fazën e kerkim-zbulimit, parashikohen vetëm punime shpimesh me sonde të cilat keto punime do të parashtrohen në kapitujt në vijim. Në këtë kuptim, në sipërfaqe nuk do të kryhen punime minerare sipërfaqësore, pasi kjo fazë punimesh është e tejkaluar. Sic e kemi permendur edhe me larte punimet ne veprimtarine minerare te kerkim zbulimit te mineralit te bakrit ne Zonen Minerare Nr.177/1 do te jene punime shpimesh me sonde, ku keto shpime do te saktesojne nese objekti paraqet interes per perspektiven bakermbajtese, per tju nenshtruar me pas fazes se shfrytezimit, prandaj kryerja e ketyre shpimeve në ndjekje të këtyre rezultateve është e domosdoshme.

2. Planimetria e vendndodhjes se projektit

(ku te pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes, te shoqeruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe te dhena per perdorimin ekzistues te siperfaqes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti, gjate fazes se ndertmit apo funksionimit te veprimtarise)

Rajoni dhe Vendburimi i bakrit Spaç, ndodhet ne pjesën qendrore të Mirditës, në anën lindore lumit të Seftës së Spaçit, që derdhet në lumin Fani i vogël, në afersi të Repsit, rreth 7 km larg tij. Në pikëpamje administrative, rajoni i Spaçit tashmë i përket Bashkisë së Rrëshenit (Qendra administrative e Mirditës) dhe Qarkut Lezhë.

Vendburimi i Spaçit ndodhet ndërmjet lumenjve Fani i Vogel dhe Seftës se Spaçit. Në të majtë të Steftës së Spaçit ndodhet vendburimi i bakrit Maja e Madhe, në veri të Spaçit ndodhet Gurth Spaçi, ndërsa në jug të tij është vendburimi Mashterkorë.




Figura 1: Pozicioni i zones minerare Veriu i Spaçit ne lidhje me ndarjen administrative.

KOORDINATAT E ZONES MINERARE Nr. 177/1				
"Objekti Veriu i Spaçit,"				
Subjekti : TETE ALBANIA TUNNEL & MINING shpk				
Nr	GAUSS-KRUGER		KRGJSH	
	X	Y	X	Y
1	4421628	4642359	504463	4641795
2	4420810	4641207	503658	4640634
3	4420819	4640428	503676	4639855
4	4421007	4640361	503865	4639790
5	4421480	4640795	504333	4640230
6	4421505	4640900	504357	4640335
7	4421400	4640900	504252	4640334
8	4421400	4641110	504249	4640544
9	4421000	4641000	503851	4640429
10	4421000	4640750	503853	4640179
11	4420900	4640750	503753	4640178
12	4420900	4641100	503749	4640528
13	4421400	4641160	504249	4640594
14	4421400	4641400	504246	4640834
15	4421900	4641400	504746	4640839

16	4421900	4640900	504752	4640340
17	4421557	4640900	504409	4640336
18	4421528	4640776	504381	4640211
19	4420683	4640003	503545	4639428
20	4421408	4639910	504271	4639344
21	4422165	4641285	505012	4640728
22	4423075	4641285	505922	4640738
23	4423076	4642147	505913	4641600
Siperfaqe = 2.742 km ²				

Tabla 1: Koordinatat e zonës minerare për kërkim - zbulimi





Figura 2: Pozicioni i zonës minerare Veriu i Spacit në lidhje me zonat e banuara.

Sic duket edhe në ortofotot e mësipërme veprimtaria e kërkimit zbulimit ndodhet larg zonave të banuara.




Figura 3: Pozicioni i zonës minerare Veriu i Spacit në lidhje me njesinë strukturore





Figura 4: Harta topografike e zones minerare Veriu i Spacit

Zona Nr.177/1




MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
 DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE DHE INDUSTRISE
 OBJEKTI "Veriu i Spaçit", Mirditë, Qarku Lezhë

Zona nr. 177/1
 Minerali Bakër
 Lloji i lejes Kërkim Zhulum
 Sipërfaqja, km² 2.742

Kordinatat		
Pika	X	Y
1	4642359	4421628
2	4641207	4420810
3	4640428	4420819
4	4640361	4421007
5	4640795	4421480
6	4640900	4421505
7	4640900	4421400
8	4641110	4421400
9	4641000	4421000
10	4640750	4421000
11	4640750	4420900
12	4641100	4420900
13	4641160	4421400
14	4641400	4421400
15	4641400	4421900
16	4640900	4421900
17	4640900	4421557
18	4640776	4421528
19	4640003	4420683
20	4639910	4421408
21	4641285	4422165
22	4641285	4423075
23	4642147	4423076



data firma
 Neritan Akksi 22.06.2022

Figura 5: Njoftim fituesi Veprimtaria Kerkim-Zbulim





Figura 6: Planvendosja e zones minerare Veriu i Spaçit.

3. Informacion per qendrat e banuara

(ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendndodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administrojnë territorin ku propozohet projekti; skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave te projektit, si dhe menytrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve dhe strukturave te projektit)

Zona Gjeografike Bashkia Mirdite: Mirdita kufizohet ne veri me Bashkite e Fushe Arresit dhe Pukes, ne perendim me Lezhes dhe ne lindje me Bashkine e Kukesit. Ne jug-lindje me bashkine Diber, ne jug me Bashkine Mat ndersa ne jug-perendim me bashkine Kurbin. Qendra e kesaj bashkie eshte qyteti i Rreshenit. Kjo bashki perbehet nga 7 njesi administrative, te cilat jane: Rresheni, Rubiku, Selite, Kthelle, Fan, Orosh dhe Kaçinar. Te gjitha njesite administrative jane aktualisht pjese e rrethit te Mirdites. Bashkia e re ka nen administrimin e saj kater qytete (Rreshen, Rubik, Kurbnesh dhe Repe) dhe 81 fshatra.



Figura 7:Harta administrative e Bashkisë Mirditë

Popullsia Bashkia Mirdite

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Mirdita ka 22,103 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 37,384 banorë. Me një sipërfaqe prej 869.71 km², bashkia e re ka një densitet prej 42.98 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 24.64 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Të dhënat tregojnë se lëvizje të mëdha demografike zhvendosëse kanë ndodhur në të gjithë bashkinë. Këto lëvizje kanë të gjitha kah negativ dhe shënojnë largim dhe ulje të popullsisë në drejtim të zonave të mëdha urbane dhe jashtë vendit. Kjo ulje e popullsisë në rang bashkie arrin në 40.35%. Gjithashtu si pjesë e Qarkut Lezhë, Bashkia e Mirditës ka numrin më të ulët të banorëve për njësi në rang qarku. Ndryshime shumë të mëdha strukturore kanë ndodhur në ekonomi, duke e përkeqësuar zhvillimin e zonës. Para viteve '90, profili ekonomik lidhej me industrinë e shfrytëzimit të pasurive nëntokësore, kryesisht bakër, pirit, krom dhe numri i punëtorëve në industrinë minerare arrinte në 12000.

Zona tone e studimit i perket nje zone rurale dhe merret kryesisht me pune bujqesore, blegtorale nje pjese e vogel eshte e punesuar ne objekte te ndryshme minerare qe jane ne aktivitet ne kete zone. Ata banojne ne fshatrat perreth qe bejne pjese ne komunat me te njejtin emer. Qendrat me te aferta te banuara jane lagjet Lekegegaj, Ndrejaj dhe Sulejman te fshatit Perlat si dhe ne qytetin e Rrubikut dhe ate te Rreshenit. Nje pjese e mire e popullsisë punon ne emigracion dhe kryesisht ne Greqi. Popullsia e pergjitheshme e fshatrave te siperpermendur eshte rreth 6200 banore.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Lezhë	Qyteti Rrëshen	Rrëshen	Qyteti Rrëshen, Fshatrat; Ndërfushas ,Ndërfan, Gëziq, Tarazh, Jezull, Kodër Rrëshen, Sheshaj, Fushë-Lumth, Malaj, Malaj Epërm, Tenë, Lurth, Bukmirë, Kulmë	22,103	37,384	870
		Rubik	Qyteti Rubik, Fshatrat; Fierzë, Bulshizë, Fang, Rasfik, Katund i Vjetër, Munaz, Rreja e Zezë, Rreja e Veles, Vau Shkezë, Rrethi i Sipërm, Livadhëz, Bulger			
		Selitë	Qyteti Kurbnesh, Fshatrat; Lufaj, Bardhaj, Lëkundë, Zajs, Kthellë e Sipërme, Kurbnesh-fshat, Mërkurth, Kumbull			
		Kthellë	Fshatrat; Perlat Qendër, Perlat i Sipërm, Shebe, Tharr, Trojë, Prosek, Rrushkull, Ujë, Shtrezë			
		Fan	Fshatrat; Klos, Shtrungaj, Bisakë, Fan, Zall-Xhuxhë, Katundi i Ri, Konaj, Shëngjin, Petoq, Xhuxhë, Dardhëz, Thirrë, Sang, Hebe, Domgjon, Gjakëz, Munellë			
		Orosh	Qyteti Reps, Fshatrat; Kullaxhi, Blinisht, Pshqesh, Mashtëkor, Shëmri, Grykë Orosh, Lgjin, Bulshar, Planet, Ndërshen, Nënshajt, Kodër-Spaç, Gurth-Spaç, Lajthizë			
		Kaçinar	Fshatrat; Kaçinar, Arrëz, Kuzhnen, Simon, Shëngjergj, Shtuf, Shpërdhezë			


Zhvillimi ekonomik Bashkia Mirdite

Zona ka karakter tipik malor dhe rural. Të ardhurat financiare të popullatës mbështeten kryesisht në prodhimet bujqësore, nga zhvillimi blegtoral dhe nga pemëtaria. Zona malore mbi lartësinë e kultivimit të hardhisë, përdoret efektshëm për kultivimin e pemëtarisë intensive (sidomos të molltoreve mbi nënshartesa xhuxhe), si dhe të zhvillimit të një bujqësie biologjike.

Tendencë është zhvillimi i blegtorisë së imët dhe sidomos të të dhirtave, pasi prodhimi i mishit, qumështit dhe sidomos të djathrave, përbëjnë një "kurs" të ri të të ushqyerit të popullsisë dhe kërkesave të tregut preferencial, prodhimet e të cilave janë të kërkuara edhe nga tregu kosovar, më i pranishëm pas ndërtimit të superstradës. Në këtë sektor është dyfishuar numri i krerëve. Nënproduktet blegtorale të zonës, si nënprodukte të karakterit bio, janë tejet të kërkuara nga tregu ynë dhe ai rajonal. Burimet kullimore të territorit të bashkisë dhe të bjeshkëve përreth bëjnë të mundur prodhime blegtorale shumë cilësore dhe me kosto të ulët, gjë që i bën konkurrese dhe të kërkuara në treg.


Interesante është edhe tendenca e shtimit të bletarisë, ku numri i koshereve të bletëve është dyfishuar brenda këtyre dy viteve të fundit. Dhe jo vetëm shtimi numerik i bletëve, por më e rëndësishmja niveli profesional i lartë për mbarështimin e bletarisë. Jo rrallë sot merret mbi 40 kg mjaltë/zgjuar. Prirje në rritje vihen re edhe në ngritjen e komplekseve të rritjes dhe mbarështimit të shpendtarisë, si dhe të rritjes së derrit. Këto janë dy aktivitete ekonomike me një konsum të madh dhe tradicional të popullsisë së rrethit të Mirditës.

3.1 Skicat dhe Planimetrite objekti “Veriu i Spacit”












CROSS SECTION 25, SPAC AREA
Scale : 1/1.000

Compiled by: Ph.D. Altan DACI (November, 2022)
According to: Geologist Gozim SHIMA, (1972);
Leader geologist Llesh Sulejmani, Risto Merdani (1961)



EXPLANATION :


- | | | | | | |
|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|
|  | Mainly andesitic pillow lavas and tufts, tuff agglomerates. |  | Copper ore body (historical results of cross section 0) |  | 174
Historical performed drill holes of 25 cross section |
|  | Sheeted dykes, basaltic, porphyritic, rhodochite |  | Non economic copper ore body (historical results of cross section 0) |  | Projected drill hole |
|  | Alteration sulphur zone |  | The possible continuity of copper ore body | | |

DESIGNED THE STUDY:		Exploration project for the mining permit No. 177/1, Spac area	
H & M MINING PROJEKTE DHE KONSULENCE		Cross section 25, Northern Spac Area	
Mining Eng. A. GALSHI		Scale 1:1000	Drawing N. 2
Ph.D. (Geologist Eng.) A. DACI			
Surveyor Eng. L. SARAQI			
ORDERED BY:			
SHQERIA 'ETE MINING ALBANA' SH.A.			

CROSS SECTION 27, SPAC AREA

Scale : 1/1,000

Compiled by: Ph.D. Aslan DACI (November, 2022)
According to: Geologist Gezim SHIMA, (1972)



EXPLANATION :


- Mainly andesitic pillow lavas and tuffs, tuffagglomerates.
- Sheeted dykes; basaltic, porphyrite, rhodacite
- Alteration sulphur zone
- Copper ore body (results of Cross section 25)
- The possible continuity of copper ore body
- No cover
- Underground works carried of 25 cross section.
- Historical performed drill holes of 27 cross section
- Projected drill hole

NOVEMBER 2022	DESIGNED THE STUDY:		Exploration project for the mining permit No. 177/1, Spac area	
	H & M MINING PROJEKTE DHE KONSULLENCE		Cross section 27, Northern Spac Area	
	Mining Eng. A. ÇAUSHI			
	Ph.D. (Geologist Eng.) A. DACI			
Surveyor Eng. L. SARAÇI		Scale	Drawing	
ORDERED BY:		1:1000	Nr. 3	
SHOCËRIA "TETE MINING ALBANIA" Sh.A.				

CROSS SECTION 33a, NORTHERN SPAC AREA

Scale : 1/2,000

Compiled by: P.R.D. ASHBY (DAC) (January, 2005)
The geological data, based on cross section 25, (District MIMA, 1972)



EXPLANATION:


- Mainly andesitic pillow lavas and tuffs, tuff agglomerates.
- Sheeted dykes, basaltic, porphyritic, tholeiitic.
- Alteration sulphur zone.
- Copper ore body (historical results of cross section 0).
- Non-economic copper ore body (historical results of cross section 0).
- The possible continuity of copper ore body.

- Historical performed drill holes of 25 cross section
- Projected drill hole

HARTCO STEELWORKS H & M MINING PROJECTS ONE HONOLULU OFFICE Via Permit: A. CALDERA Via Mining: A. DACI Via Research: L. SERRAO HONOLULU, HAWAII "H & M MINING ALUMINA" S.A.		Project: 33a Northern Spac Area 1/1/01, 1/2005 Spac Project: 33a Northern Spac MIMOTE Sheet: 1/100 Volume: 1/1
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

GEOLOGICAL MAP OF SOUTHERN SPAC AREA, WITH PROJECTED DRILLHOLE
SCALE 1/2,000

Compiled by : Ph.D. Aslan DACI (March 2019)
Based on Geological Map of Spaci Deposit (1989)




EXPLANATION

- | | | |
|--|--|--|
| | | |
| | | |
| | | |

NOVEMBER 2022	DESIGNED THE STUDY: H & M MINING PROJEKTE DHE KONSULLENCE Mining Eng. A. CAUSHI	Exploration project for the mining permit No. 17771, Spac area
	Ph.D. (Geologist Eng.) A. DACI Surveyor Eng. L. SARAÇI	Geological map of southern Spac Area, with projected drillholes
	ORDERED BY: SHOCERIA "TETE MINING ALBANIA" SH.A.	Scale 1:2000 Drawing No. 5

CROSS SECTION 0, SOUTH SPAC AREA
Scale : 1/2,000

Completed PFD: 2016 (DCT) Presentation: 2020
Based on cross section 0, South Spac. (Scale: according to
Geological Eng. Dr. MOHAMMED LAM. ELZEMANI (1984)




EXPLANATION:

- | | | | |
|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|  |  |  |  |
|  |  |  | |
|  |  |  | |




DESIGNED THE STUDY: HAMMAMU PROJECT (THE HONDA ZEMO)		Preparation period by the meeting period: 16.11.11, 2016 area
Dr. Mohamed El-Zemani	Dr. Mohamed El-Zemani	Checked by: Dr. Mohamed El-Zemani
Dr. Mohamed El-Zemani	Dr. Mohamed El-Zemani	Scale: 1:2000
Dr. Mohamed El-Zemani	Dr. Mohamed El-Zemani	Sheeting: No. 2




CROSS SECTION 2, SOUTH SPAC AREA
Scale : 1/1,000


Compiled by: Ph.D. Aslan DACI (November, 2022)




EXPLANATION :

-  Mainly andesitic pillow lavas and tufts, tuffagglomerates.
-  Andesite/basaltic pillow lavas and basaltic massive flow
-  Alteration sulphur zone

-  Copper ore body (historical results of cross section 0)
-  Non economic copper ore body (historical results of cross section 0)
-  Expected results


 Projected drill hole

NOVEMBER 2022	DESIGNED THE STUDY:		Exploration project for the mining permit No. 17711, Spac area	
	H & M MINING PROJEKTE DHE KONSULENCE		Cross section 2, Southern Spac Area	
	Mining Eng. A. ÇAUSHI			
	Ph.D. (Geologist Eng.) A. DACI			
Surveyor Eng. L. SARACI				
ORDERED BY:		Scale 1:1000	Drawing No. 7	
SHQËRIA 'ETE MINING ALBANIA' Sh.A.				

CROSS SECTION 24, SOUTH SPAC AREA

Scale : 1/2,000

Compiled Ph.D. Aslan Daci (November, 2022)
Based on cross section 24, South Spac Area,
according to Geologist Eng; Gjon KAZA, Nikoll NDRECA (1996)



EXPLANATION :


- | | | | | | |
|--|-------------------------------------------------------------------------|--|---------------------------------------------------------|--|----------------------------------|
| | Ophiolitic melange | | Sheeted dykes; basaltic, porphyrite, rhiodacite | | Historical performed drill holes |
| | Mainly agglomeratic andesitic pillow lavas and tuffs, tuffagglomerates. | | Copper ore body (historical results of cross section 0) | | Projected drill hole |
| | Andesitebasalte, basaltic pillow lavas and basaltic massive flow | | Alteration sulphur zone | | |

NOVEMBER 2022	DESIGNED THE STUDY:	Exploration project for the mining permit No. 1771, Spac area
	H & M MINING PROJEKTE DHE KONSULLENCE	
	Mining Eng. A. ÇALSHI	
	Ph.D. (Geologist Eng.) A. Daci	
	Surveyor Eng. L. SARAÇI	Cross section 24, Southern Spac Area
	ORDERED BY:	Scale 1:2000
	SHQËRIA 'ETE MINING ALBANIA' Sh.A.	Drawing No. 9

CROSS SECTION 26, SOUTH SPAC AREA

Scale : 1/1,000

Compiled by : Ph.D. Aslan DACI (November, 2022)
Based on cross section 26 Southern Spac, according
to Geologist Eng: Gjon KAZA & Nikoll NDRECA (1999)




EXPLANATION :

- VA VA Mainly andesitic pillow lavas and tuffs, tuffagglomerates.
- VA VA Andesite/casalte, basaltic pillow lavas and basaltic massive flow
- VA Alteration sulphur zone
- [Red hatched] Copper ore body (historical results of cross section 0)
- [Yellow hatched] Non economic copper ore body (historical results of cross section 0)
- [Green hatched] Expected continuity of copper ore bodies
- | Projected drill hole

NOVEMBER 2022	DESIGNED THE STUDY:		Exploration project for the mining	
	H & M MINING PROJEKTE DHE KONSULCENCE		perm# No. 177/1, Spac area	
	Mining Eng. A, ÇAUSHI		Cross section 26, Southern Spac Area	
	Ph.D., Geologist Eng. A, DACI			
Surveyor Eng. I, SARAÇI				
ORDERED BY:		Scale	Drawing	
SHQOPËJA "ETE MINING ALBANIA" Sh.A.		1:1000	No. 10	

HORIZONTAL PLAN OF COPPER ORE BODIES OF NORTHERN SPAC AREA SCALE 1:2,000

Compiled by: Geologist Eng. Ph.D. Aslan DACI (November, 2022)




EXPLANATION

- The location of the designed drilling
- The point of Intersection of the ore bodies

DESIGNED THE STUDY:			
H & M MINING PROJEKTE DHE KONSULCENCE			
NOVEMBER 2022	Mining Eng. A. ÇAUSHI		Horizontal plan of copper ore bodies of Northern Spac Area
	Ph.D. (Geologist Eng.) A. DACI		
	Surveyor Eng. L. SARAÇI		
ORDERED BY:		Scale 1:2,000	Drawing Nr. 12
SHQËTRIA *TETE MINING ALBANIA* Sh.A.			

HORIZONTAL PLAN OF COPPER ORE BODIES OF SOUTHERN SPAC AREA SCALE 1:2,000

Compiled by: Geologist Eng. Ph.D. Asllan DACI (November, 2022)



- EXPLANATION**
- The location of the designed drilling
 - The point of Intersection of the ore bodies

NOVEMBER 2022	DESIGNED THE STUDY: H & M MINING PROJEKTE DHE KONSULCENCE		Exploration project for the mining permit No. 177/1, Spac area	
	Mining Eng. A. ÇAUSHI		Horizontal plan of copper ore bodies of Southern Spac Area	
	Ph.D. (Geologist Eng.) A. DACI			
	Surveyor Eng. L. SARAÇI		Scale 1:2,000	Drawing Nr. 13
ORDERED BY: SHQËPRIJA "TETE MINING ALBANIA" Sh.A.				

Figura 8: Prekje dhe projeksione

4. Pershkrimin e proceseve ndertimore dhe teknologjike (perfsjire kapacitetet prodhuese /perpunuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit)

Mënyra e propozuar e kërkim-zbulimit të mineralit të bakrit të zonës

- Fazat e zhvillimit të programit të punës (faza e kërkimit, faza e zbulimit / faza e zbulimit):

a) Faza e parë (faza e kërkimit);

Në këtë fazë do të thellohet njohja me punimet historike të kryera në territorin e lejes së zbulimit, do të shfrytëzohet materiali arkivor në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar dhe në vazhdim do të bëhen disa vrojtime gjeologjike në terren në trajtën e marshutave me qëllim saktësimin e gjeologjisë dhe të mineralizimit sulfuror të bakrit në këtë zon. Kjo do të zgjasë vetëm 1 muaj.

b) Faza e dytë (faza e zbulimit);

Do të jetë faza kryesore e kryerjes së aktivitetit minerar të Shoqërisë TETE ALBANIA TUNNEL & MINING” Sh.A. në territorin e lejes së zbulimit.

- Lloji i punimeve gjeologjike të projektuara sipas fazave:

Në fazën e parë të kërkimit, do të planifikohen rreth 50 km marshuta kërkimi në shkallën 1:10,000, për saktësime të mëtejshme gjeologjike, të tektonikës dhe të mineralizimit. Në këtë rajon, gjatë periudhës së kërkim zbulimit të vendburimit të Spaçit, janë kryer punime minerare sipërfaqësore, punime të rralla nëntokësore, si dhe shumë shpime kërkimore dhe zbulimi. Në këtë kuptim, në sipërfaqe nuk mendojmë të kryhen punime sipërfaqësore, pasi kjo fazë punimesh është e tejkaluar.

Në fazën e zbulimit, parashikohen vetëm punime shpimesh, të cilat do të parashtrohen në kapitujt në vijim.

Përshkrimi i programit të kërkim-zbulimit të propozuar

- Studimet gjeologjike dhe punimet e projektuara në zonën e kërkuar për leje kërkim- zbulimi;
- Studimet hidrogjeologjike (*nuk do të ketë*);
- Studime teknologjike (*nuk do të ketë*);
- Fazat e kryerjes së punimeve sipas afateve (*punime kërkimi, punime zbulimi*);

Në fazën e parë të kërkimit, do të kryhen rreth 50 km marshuta të shkallës 1:10,000 me qëllim saktësimin e mëtejshëm të gjeologjisë, të tektonikës dhe të mineralizimit në rajon, në funksion të realizimit projektit me shpime të zbulimit. Këto marshuta në kohë, dotë realizohen para fillimit të kryerjes së punimeve të shpimit të fazës së zbulimit dhe nuk do të ketë një periudhë kohore vetëm kërkimi, sepse realizimi i marshutave do të zgjasë vetëm 10 ditë, ndërkohë që do të studjohen të dhënat arkivore për t’u njohur me problematikat e evidentuara gjatë periudhës historike të kërkim-zbulimit. Do të synohet qënë këndvështrimin e sotëm të gjeologjisë së rajonit, të bëhet ndonjë saktësim dhe plotësim.

- Punimet gjeologjike të projektuara

Duke analizuar hollësisht të dhënat gjeologjike të profileve të zbulimit të vendburimit Spaç, të raportit gjeologjik me autorë; Gëzim Shima (1972) dhe Ded Kolndreu etj. të vitit 1984, vërehet se në disa shpime historike të kryera në profilet 23, 25, 27 dhe 33 në horizontin 500 – 650 takohen disa trupa xeherorë, me përmbajtje të lartë bakri që arrin në vlerat nga 2% deri në 8.41% Cu dhe më shumë.

Në këtë detyrë projektimi, është synuar të zbulohen rezerva të reja bakri në profilet veriorë dhe jugorë të vendburimit të Spaçit, të përfshira në lejen minerare të kërkim zbulimit Nr. 177/1.

Profili 25, Spaçi Verior – Projektohet shpimi nr. **TM-01/22**, me kënd 73°, azimut 282° dhe thellësi 220 m. Ky shpim ndjek në rënije, rezultatet pozitive të niveleve të minierës Spaç në profilin 23 (**8 m @ 1.75%Cu; 4 m @ 2.6% Cu**).

Profili 27, Spaçi Verior – Është 100 m më në veri të profilin 23, në shtrirje të zonës minerale Spaç. Në ndjekje të rezultateve të shfrytëzimit të minierës në profilin 23 (**8 m @1.75%Cu; 4 m @ 2.6% Cu**), projektohen të pavarura shpimet nr. **TM-02/22, TM-03/22**, me kënde respektive 70° dhe 83° dhe thellësi 86 m dhe 210 m. Në vartësi të rezultateve tëshpimit **TM-03/22**, mund të kryhet shpimi nr. **TM-04/22**, me kënd 83° dhe thellësi 230 m. Në të gjitha rastet azimuti drejtimit të shpimeve të projektuara është 282°.

Profili 33a, Spaçi Verior – Me hap të largët kërkimi, 230 në shtrirje më në veri të zonës minerale të vërtetuar në minierën Spaç, projektohen dy shpime për të kontrolluar vazhdimësinë e mineralizimit e mundshëm në dy nivelet kryesore të vendburimit Spaçit 700 dhe 500.

Për të kontrolluar mineralizimin e mundshëm të bakrit në nivelin 700, mbështetur edhe nga të dhënat e minierës në profilin 23, projektohet shpimi nr. **TM-05/22**, me kënd 77° dhe azimut 282° dhe me thellësi 90 m. Më në lindje në këtë profil, projektohet shpimi nr. **TM- 06/22, me kënd 86° dhe thellësi 300 m**, për të kontrolluar mineralizimin e mundshëm të bakrit në nivelin kryesor të këtij vendburimi 700, i vërtetuar tashmë nga shumë punime historike kërkim zbulimi dhe shfrytëzimi në vendburimin e Spaçit. Punimet e shfrytëzimit të minierës për rreth 40 vjet, kanë konfirmuar nivelin e mineralizimit 500-550 m, si nivelin më të qëndrueshëm të mializimit të bakrit në vendburimin e Spaçit dhe rajonin përreth tij, në ndryshim të plotë me mineralizimet polimetalore të Gurth Spaç-Lëtitën e më në veri deri në Lak Roshi në ekstremin më verior të rajonit Repts – Qafë Mali

Profili 0, Spaçi Jugor – Paraqitet si një profil mbështetës për shpimet e projektuara në profilin 2, 50 m më në jug të këtij profili. Në vartësi të rezultateve të shpimit nr. **TM-08/22** në profilin 2, mund të kryhet në këtë profil shpimi nr. **TM-07/22**, me kënd 73°, azimut 282° dhe thellësi 220 m.

Profili 2, Spaçi Jugor – Mbështetur në rezultatin e shpimit historik nr. 7 të kryer në profilin 0 me rezultate: (3 m @ 1.52% Cu; 5 m @ 0.76% Cu; si & 4 m @ 1.80% Cu), projektohet i pa varur (ose i radhës parë) shpimi nr. **TM-08/22**, me kënd 76°, azimut 282° dhe thellësi 310 m. Më në rënije në vartësi të rezultatit të shpimit **TM-08/22**, projektohet shpimi nr. **TM-09/22**, me kënd 85°, azimut 282° dhe thellësi 350 m.

Profili 16, Spaçi Jugor – Për të ndjekur vazhdimësinë e mundshme të mineralizimit sulfuror të bakrit më në shtrirje, 360 m më në jug të profilin 2 dhe mbështetur nga disa rezultate historike të profilin 24 rreth nivelin 500, projektohet më të pavarur shpimin nr. **TM- 10/22**, me kënd 57°, azimut 282° dhe me thellësi 475 m. Në vartësi të rezultateve të këtij shpimi, mund të hapet perspektivë e rëndësishme për zbulime të reja rezervash xeherore nëSpaçin Jugor.

Profili 24, Spaçi Jugor – Në këtë profil, projektohet për t'u kryer si i radhës së dytë, shpimi nr. **TM-11/22**, me kënd 87°, azimut 282° dhe me thellësi 412 m.

Profili 26, Spaçi Jugor – Në profilin 26, janë kryer disa shpime historike dy prej të cilave kanë prerë rezultate shumë të mira për bakër të pasur; (**4.40 m @ 8.94%Cu; 7.70 m @ 2.83% Cu**). Në ndjekje të këtij trupi xeheror më në rënije, projektohet shpimi nr. **TM- 12/22**, me kënd 84°, azimut 282° dhe me thellësi 320 m. Më në rënije të këtij shpimi projektohet i varur nga rezultati i të parit, shpimin nr. **TM-13/22**, me kënd 83°, azimut 282° dhe me thellësi 400 m.

Profili 28, Spaçi Jugor – Mbështetur në rezultatet e shpimeve 662/1 dhe 662/2 të profilin 26 me rezultate respektive; (**4.40 m @ 8.94%Cu; 7.70 m @ 2.83% Cu**), projektohet shpimi nr. **TM-14/22**, me kënd 82°, azimut 282° dhe me thellësi 360 m. Në vartësi të rezultatit të këtij shpimi, projektohet i varur shpimi nr. **TM-15/22**, me kënd 82°, azimut 282° dhe me thellësi 432 m.

Totali i shpimeve për t'u kryer si të pavarura (të radhës së parë), janë gjithësej 9, me një metrazh të përgjithshëm prej 2371 ml.

Lloji i Punimeve të projektuara dhe volumi i tyre:

Lloji i Punimeve	Vëllimi i tyre
Studim, projektim, vlerësim	1 copë
Marshuta gjeologjike, vrojtme në terren	50 km
Rilevim topografik në shkallë 1:2000	-
Rilevime, redaktime gjeologjike në shkallë 1:10,000 etj.	-
Rilevim gjeologjik në shkallën 1:2000	-
Kanale	-
Puse, pusëza	-
Pastrime, gërmime	-
Shpime	2,371 ml
Galeri, ringritje galerie	-
Karriera	-
Aaliza kimike	300 copë
Testime teknologjike	-

Koordinatat e punimeve të projektuara (Shpime):

Tabela e punimeve të projektuar (për çdo shesh) në zonën minerare Nr177/1

Nr.	Nr. i punimit	Profili	Azimuti	Këndi	Thellësia	Koordinatat e punimeve	
			në (°)	në (°)	në (ml)	X	Y
1	TM - 01/22	25	282	73	220.00	4421660.00	4641428.00
2	TM - 02/22	27	282	70	86.00	4421608.00	4641490.00
3	TM - 03/22	27	282	71	210.00	4421675.00	4641476.00
4	TM - 05/22	33a	282	71	90.00	4421626.00	4641665.00
5	TM - 06/22	33a	282	86	300.00	4421733.00	4641643.00
6	TM - 08/22	2	282	76	310.00	4421590.00	4640729.45
7	TM - 10/22	16	282	57	475.00	4421555.60	4640382.09
8	TM - 12/22	26	282	84	320.00	4421268.75	4640182.28
9	TM - 14/22	28	282	82	360.00	4421282.69	4640132.71
Total:					2,371.00		

Llogaritja e rezervave të pritshme për mineralin e bakrit brenda zonës së lejes së kërkuar.

Llogaritja e rezervave të pritshme për xeherorët e bakrit, në objektin “Veriu i Spaçit” për të cilin është marrë kërkuar leja e kërkim-zbulimit është bërë me metodën e prerjeve vertikale paralele, në projeksione horizontale. Rezervat C1, janë konturuar në intersektimin e pikës shpimit me trupin xeherorë të pritshëm, ndërsa rezervat C2, mbështeten në rezervat C1, në gjysmën e gjatësisë së rrjetit të zbulimit (50x40 m), që dë të thotë në shtrije 25 m nga rezultati i prishëm dhe në rënije 20 m. Sipërfaqet janë matur në profil aty ku priten rezultatet e intersektimit të trupit xeherorë. Meqenëse në të gjitha rastet në projektin konkret, në shtrirje rezervat e pritshme mbështeten vetëm në një pikë rezultative ose me ekstrapolim nga rezultati i pritshëm, për llogaritjen e volumit të rezervave është përdorur formula e “trungut të konit” (1/3SxL), ndërsa pesha volumore për xeherorët e bakrit në këtë zonë është marrë 2.8 ton/m³, si në rastet analoge për vendburimin Spaç.

5. Informacionin per infrastrukturen e nevojshme

per lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe rnbetjeve, si dhe informacionin per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja;

- **Furnizimi me energji elektrike, uje dhe telefoni**

Gjate fazës se kerkim zbulimit nuk parashikohet të përdoren makineri dhe pajisje të ndryshme të cilat punojnë me energji elektrike, ndërsa më vonë neqoftese kjo zone kosiderohet me interes te larte per perspektiven bakermbajttese, per tju nenshtruar me pas fazes se shfrytezimit, atehere do te nevojitet perdorimi i energjise elektrike, per tu pajisur me te gjithë aksesoret e tjere te nevojshem. Lidhja telefonike e objektit me subjektin do të bëhet me telefona mobile dhe fikse.

- **Rruga automobilistike për hapjen e shesheve te kerkim zbulimit**

Për realizimin e punimeve të kërkim zbulimit nga qendra e minierës Spaç drejt veriut dhe jugut të minierës ku përfshihet leja nr. 177/1 (Veriu I Spacit), nuk ka rrugë automobilistike. Rruga për transportin e sondës dhe të paisjeve të tjera mbështetëse do të hapet me makineritë që ka Shoqëria "TETE ALBANIA TUNNEL & MINING" SH.A. në dispozicion. Theksojmë se për specifikën që ka kryerja e këtyre punimeve, terreni i përdorur për këtë qëllim, është shumë i kufizuar, që përshin vetëm 9 sheshe shpimi me sipërfaqe të përgjithshme 1000 m² dhe rruga për në sheshet e shpimit do te jete relativisht e shkurter.

Rruga do të shërbejë për lidhjen e shesheve me pjesen e poshtme te rruges e cila do te lidhet me fabriken e pasurimit Spac.

- **Objekte te tjera**

Nuk ka nevojë për ngritje kantieri, sepse projekti do të menaxhohet nga kanieri tashmë i ngritur i minierës Spaç në aktivitet, i cili është shumë afër sektorit ku do të kryhen shpimet e kërkim-zbulimit.



Figura 9: Zona minerare ne lidhje me infrastrukturen rrugore ekzistues

6. Programin per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatjen e planifikuar per funksionimin e projektit

kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe, sipas rastit, edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes, pas mbarimit te funksionimit te projektit;

Sigurisht puna do te filloje me hapjen e infrastruktures se nevojshme, ku do te konsistoje ne hapjen e rruges se aksesit si dhe siperfaqet e shesheve te kerkim zbulimit. Me pas faza e kerkim zbulimit do te shoqerohet me proceset e shpimit me sonde per nxjerrjen e kampionit te tokes, sipas programit te hartuar nga administrata drejtuese e shoqerise "Tete Albania Tunnel & Mining"

Ne kete faze do te sigurohen edhe furnizimet me uje per shpim, uje te pishem si dhe te gjitha materialet e nevojshme.

Kohezgjatja e punimeve te kerkim zbulimit prashikohen te zgjasin per nje periudhe 2-3 vjecare, por nje afat kohor me i mirepercaktuar do te caktohet me marrjen e lejes minerare.

7. Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji);

Lëndët e para që do të përdoren për ndërtim janë: lende djegese, vajra lubrifikant, tuba hekuri, uji si dhe reagente qe perdoren per daljen e kampionit, etj. Karburanti dhe vajrat do te sherbejne per automjetet e transportit si dhe per sonden e cila do te sherbeje per shpim. Te gjitha lendet e para do te sigurohen nga subjekte private te licensuara per tregtimin e tyre.

Uji do te perdoret per shpim dhe me pas do te lihet te denkantoje ne shtresat e nentokes ne gjendje te lire. Furnizimi me energji elektrike qe do te perdoret per ambientet ndihmese do te behet nepermjet linjes elektrike ne zone.

8. Informacioni per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/prane zones se projektit;

Shoqëria "TETE ALBANIA TUNNEL & MINING" SH.A., që ushtron aktivitet shfrytëzimi prej 15 vjetësh, që nga viti 2007 në minierën e Spaçit dhe në disa objekte minerare të tjera më në veri të Spaçit, të tilla si;

në Gurth Spaç, Koshaj dhe Letitën, ka eksperiencën dhe kapacitetet e duhura tekniko-profesionale dhe të paisjeve mekanike, për zhvillimin normal të këtij aktiviteti minerar. Në kuader të plotesimit të nevojave të fabrikës egzistuese të pasurimit të bakrit shoqëria nepermjet ketij projekti synon kerkim-zbulimin për nxjerrjen e koncentratit shtese të bakrit nga minerali i vendburimit Veriu i Spacit. Në fazën përfundimtare të kerkim zbulimit do të përcaktohet neqoftese kjo zonë minerare është me interes dhe perspektivë shfrytëzimi për sasine dhe cilësi bakërbajtëse, kryerja e këtyre shpimeve në ndjekje të këtyre rezultateve është e domosdoshme.

9. Informacion për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

Shoqëria “Tete Albania Tunnel&Mining” Sh.a është pajisur me Njoftim Fitues nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë Nr.6295/2 Prot., Datë 14.10.2022. Zona Minerare Nr.177/1, për objektin “Veriu i Spacit”, Mirditë, Qarku Lezhë, lloji i mineralit bakër, veprimtaria kerkim-zbulim.

10.Përdorimi i lendeve të para gjatë funksionimit të aktivitetit (uji, energjia, lenda djegëse) dhe menyrat e sigurimit të tyre

Nisur nga fakti që ky aktivitet është aktivitet kerkim-zbulimi i burimeve natyrore, nuk përdoren lende të para por sigurohen lende të para të cilat janë minerali i bakrit. Ky mineral/kampion do të nështrohet proceseve të tjera teknologjike/laboratorike për të përcaktuar cilësinë e mineralit.

Lendet e para ndihmëse që do të përdoren gjatë kohës së kerkim-zbulimit janë lenda djegëse, vajra lubrifikant për automjetet e transportit dhe sondes, tubacion hekuri, uji si dhe reagente të ndryshme që përdoren për daljen e kampionit.

Lendet e para ndihmëse si lenda djegëse, vajra lubrifikant dhe tubacione hekuri do të sigurohen nga subjektet private të licencuar për tregtimin e tyre. Furnizimi me energji elektrike për ambientet ndihmëse do të bëhet nepermjet linjës elektrike në zonë. Lidhja telefonike e objektit me subjektin do të bëhet me telefona mobile.

11. Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit, si ndertimi i kampeve apo rezidencave

Për realizimin e punimeve të kërkim zbulimit nga qendra e minierës Spaç drejt veriut dhe jugut të minierës ku përfshihet leja nr. 177/1 (Veriu i Spacit), nuk ka rrugë automobilistike. Rruga për transportin e sondës dhe të paisjeve të tjera mbështetëse do të hapet me makineritë që ka Shoqëria “TETE ALBANIA TUNNEL & MINING” SH.A. në dispozicion. Edhe transporti për në sheshet e shpimit, do të realizohet me makineritë e Shoqërisë. Rruga do të shërbejë për lidhjen e minierës në pjesën e poshtëme të fshatit dhe me lidhjen e rruges automobilistike e cila do të beje lidhjen me fabriken e pasurimit Spac.

Sheshet e punimeve të kërkim zbulimit;

Sheshet e kërkim zbulimit janë 9, të cilat bien në terren kodrinor malor dhe do të hapen me makineritë e minierës, në terren të vështirë, sto do të hapen me krahë nga punëtorët.

Ngritja e kantierit (zyra, pajisje orendi dhe ambiente të tjera si: banja, gardërobë, fjetore, mense, magazine materialesh, kabina elektrike, gjenerator, stacion pompimi, depo e lëndës plasëse, etj.).

Nuk ka nevojë për ngritje kantieri, sepse projekti do të menaxhohet nga kanieri tashmë i ngritur i minierës Spaç në aktivitet, i cili është shumë afër sektorit ku do të kryhen shpimet e kërkim-zbulimit.

12. Informacion per lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme per projektin, (ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit)

Shoqëria “Tete Albania Tunnel&Mining” Sh.a është pajisur me Njoftim Fitues nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise Nr.6295/2 Prot., Date 14.10.2022. Zona Minerare Nr.177/1, per objektin “Veriu i Spacit”, Mirditë, Qarku Lezhë, lloji i mineralit baker, veprimtaria kerkim-zbulim.

13. Kopje te lejeve, autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar (ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin/autorizimin/licensimin e projektit.)

RAPORT TEKNIK

Shoqeria "Tete Albania Tunnel&Mining" Sh.a eshte pajisur me Njoftim Fitues nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise Nr.6295/2 Prot., Date 14.10.2022. Zona Minerare Nr.177/1, per objektin "Veriu i Spacit", Mirditë, Qarku Lezhë, lloji i mineralit baker, veprimtaria kerkim-zbulim.